

AKT - THEMELIMI
(KONTRATE)
I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR

CONTINENTAL SH.P.K.

Une, **Arben KACOS**, i biri i Qaniut, i dtl.1969, lindur dhe banues ne Vreshtas te Korces, ne baze te legjislacionit shqiptar vendosa :

Neni 1

Te themeloj nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike e emeruar **CONTINENTAL Sh.p.k. me ortak te vetem Z. Arben KACOS**.

Neni 2

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbiet deri ne kufirin e vleres te derdhur ne kapitalin themelor.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj, ne Vreshtas te Korces .
Ajo ka te drejte te krijoj brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

Neni 4

Shoqeria do te kete nje kohezgjitie me nje kufi te pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te ortakut te vetem.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor I Shoqerise do te jete **100.000 (njqind mije)** leke , kapital I cili eshte I formuar teresisht nga ortaku i vetem themelues i saj.

Neni 6

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregetare do te shenohet dhe kapitali I derdhur nga ortaku.
Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte e kufizuar.

Neni 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaku i vetem i Shoqerise.



Neni 8

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete :

- Tregetimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice , import - eksport .
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore .
- Tregetim karburantesh te ndryshme , vajra lubrifikante , lende djegese te cdo lloji e tipi .
- Tregetim automjesh te cdo lloji , marke e tonazhi , si dhe pjese kembimi per to .
- Tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venien e tyre ne shfrytezim .
- Tregetim paisjedh elektro - shtepiake , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati etj.
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit .
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit .
- Tregetim plerash e prodhimesh te tjera kimike .
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Tregetim bimesh eterovajore.
- Transport mallrash e pasagjeresh , brenda dhe jashte vendit .
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh , baresh , restorantesh , diskotekash , qendrash pushimi e kurative .
- Punime duralumini e tregetimi I tyre .
- Punime druri , tregetime prodhimesh te ndryshme druri , mobilje orendi etj.
- Investime dhe pjesemarrje ne investime , duke bashkepunuar me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja ne fusha te ndryshme si :
- Industri
- Bujqesi
- Industrine ushqimore
- Ndertim
- Transport
- Hoteleri
- Per arritjen e qellimit te mesiperem Shoqeria ka te drejte te zhvilloje cfaredo lloj aktiviteti industrial , tregetar , financiar , dhenien e garancive te cfaredo lloj natyre edhe ipotekore per detyrime te shoqerise ose edhe te te treteve , te disponoje cfaredo lloj license , te marre pjese ne cfaredo lloj shoqerie qe zhvillon aktivitet te njeje apo te ndryshem me te .

Neni 9

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetie te ligjit Nr. 7961, date 12.07.1995 (Kodit te Punes), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Neni 10

Ortaku i vetem nuk kufizohet ne rritjen e kapitalit te shoqerise .

2

2

2

2

Neni 11

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime
vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku I vetem themelues mbart rrezikun e
veprimtarise se Shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne Shoqeri.

Neni 12

Mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te shoqerise
midis punonjesve brenda saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me
mirekuptim , ceshtia mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit te Tiranes, ku do te
jete dhe rregjistri tregetar I saj .

Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit te saj.

Neni 14

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet prane Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

Neni 15

Organet e shoqerise **CONTINENTAL Sh.p.k.** jane:

Ortaku i Vetem i shoqerise .

Administratori I shoqerise .

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e
shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete Ortaku i Vetem **Z. Arben KACOS .**


Modalitete per ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga
statuti I shoqerise dhe ligji 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare",

Ky Akt - Themelim eshte perpiluar ne kater kopie me vlere te njejte me origjinalin.

Tirane, me 21/01/1999

THEMELUES :

Arben KACOS

Arben Kacos


3

3

3

3